



Regione Puglia



**Marrëveshje Bashkëpunimi midis  
Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë  
dhe  
Rajonit të Pulias**

**Për konkretizimin e projektit  
"Shokë dhe Engjëj"- Drejt Oficinave të Kulturës "**

---

**Preamble**

- **Duke pasur parasysh**, protokollin e bashkëpunimit të nënshkruar në Bari më datë 12.09.2016 midis Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Rajonit të Pulias i cili parashikon nisjen e iniciativave të përbashkëta të projektit në besimin e përbashkët që arti, kultura, industria kulturore dhe krijuese, turizmi kulturor, pasuritë natyrore dhe kulturore janë temat kryesore për të zhvilluar një përmirësim efektiv të atraktivitetit të territoreve përkatëse;
- **Duke pasur parasysh**, edhe tryezat e punës dhe projektet e ndryshme, së fundmi Bienalja e Artistëve të Rinj të Evropës dhe Mesdheut, të cilat në vitet

e fundit kanë konsoliduar bashkëpunimin institucional dhe ndërkulturor ndërmjet organizatave nënshkruese;

- **Duke pasur parasysh që**, në kuadrin e prioriteteve dhe temave të përbashkëta të lartpërmendura, Qeveria Shqiptare po fokusohet në rimëkëmbjen dhe valorizimin në shkallë urbane dhe territoriale, me një vëmendje të veçantë mbi rivlerësimin e vendeve të kujtesës kolektive të lidhura me të kaluarën e afërt;
- **Duke pasur parasysh që**, me rastin e 80 vjetorit të vdekjes së Antonio Gramscit, Rajoni i Pulias ka përkrahur iniciativat e rëndësishme kulturore të propozuara nga Fondacioni Gramsci Onlus dhe nga Fondacioni Gramsci të Pulias, me theks të veçantë në ekspozitën "*Gramsci, fletoret dhe librat e burgut*" në Muzeun Civico të Bari-t, dhe në konferencën ndërkombëtare me titull "*Gramsci, lufta dhe revolucioni midis Lindjes dhe Perëndimit*", në bashkëpunim me Universitetin e Barit;
- **Duke pasur parasysh që** pas shumë diskutimeve, subjektet nënshkruese kanë zhvilluar idenë e krijimit të një projekti të përbashkët në lidhje me figurën e jashtëzakonshme intelektuale dhe politike të Antonio Gramsci-t, familja e të cilit është me origjinë nga Shqipëria, për të konsoliduar lidhjet e pandashme midis dy brigjeve të Adriatikut; në veçanti, u ndanë për të punuar në një projekt më të gjerë që kombinon kujtesën e Gramsci-t dhe temat kulturore që lidhen me figurën e tij, me rivitalizimin e vendeve periferike (p.sh. Parku pranë Ministrisë së Kulturës në Tiranë, zonat publike që rrrethojnë burgun e Turit) si parakusht për veprimet e përbashkëta pasuese të valorizimit ndërmjet dy territoreve;
- **Duke pasur parasysh që**, Fondazioni Gramsci i Pulias prezantoi një ide të projektit të mjeshtrit Alfredo Pirri, një nga interpretuesit më autoritarë të "artit publik" të Evropës, i cili i përgjigjet nevojave të valorizimit kulturor dhe territorial të përmendor më lart, të titulluar "*Shokë dhe Engjëj*", bashkangjitur Aneks A në këtë marrëveshje, pjesë integrale dhe thelbësore të saj;
- **Duke marrë parasysh që**, pas takimeve të shumta institucionale, edhe në prani të ambasadorit shqiptar në Romë, dhe pas progresit të aktivitetit të planifikimit të kryer nga grupei teknik i punës, në bazë të projektit artistik "*Shokë dhe Engjëj*" një projekt ide më gjithëpërfshirëse që përfshin aspektet

kulturore, artistike, arkitektonike, urbane dhe historike, të quajtura "Officine të Kulturës";

- **Duke konsideruar gjithashtu se:**

- Palët nënshkruese në këtë marrëveshje kanë propozuar së bashku projekt-ide për Bienalen e 16-të, të Arkitekturës së Venecias të planifikuar që nga 26 maji deri më 25 nëntor 2018;
- Në bazë të projekt-idesë së lartpërmendur, janë identifikuar elementë me interes të madh edhe nga Qendra e Artit Bashkëkohor në Pallatin Petroviç (Podgoricë), i cili bashkëpunon me mjeshterin Pirri dhe ndan vizionin e përgjithshëm të iniciativës.

-Duke vlerësuar mundësitë e paraqitura nga Programe të ndryshme financuese të Bashkëpunimit Territorial të Bashkimit Evropian, në të cilat Pulia dhe Shqipëria janë territore perfituese të projektideve të përbashkëta, dhe me theks të vecantë në Programin IPA CBC Itali- Shqipëri – Mali i Zi 2014-2020 dhe projektet tematike të tij,

**Cdo gjë që është parashtruar më lart dhe merret në shqyrtim nga :**

*Ministri i Kulturës i Republikës së Shqipërisë, Znj. Mirela Kumbaro Furxhi  
dhe*

*Presidenti i Rajonit të Pulias, Dr. Michele Emiliano*

**BIEN DAKORT SA MË POSHTË:**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Rajoni i Pulias, nëpërmjet Departamentit të saj të Industrisë Kulturore dhe Turizmit - Departamentit të Turizmit, Ekonomisë së Kulturës dhe Valorizimit Territorial dhe me mbështetjen e subjekteve kompetente rajonale, angazhohen që të perpunojnë projektin artistik të quajtur "Shokë dhe Engjëj -Drejt Oficinave të Kulturës ", shoqëruar me dokumentat si më poshtë:
  - a. *masterplanin* e veprës artistike dhe të projektit të përgjithshëm urbanistiko-arkitektonik;

- b. *masterplanin* e veprës artistike të valorizimit të qelisë së burgut të Gramsci-t në Turi dhe i projektit të përgjithshëm urban /arkitekturor në zonat publike që rrrethojnë shtëpinë e qarkut të Turit ("Shokë dhe Engjëj 1.);
- c. prodhimin grafik dhe *pasqyrimin* 3D të projekteve;
- d. vënien në dispozicion të një *faqe interneti* dhe komunikimin social-mediatik të iniciativave;
- e. vlerësimin e kostove paraprake të projektit ekzekutiv.
- f. afatin kohor të aktiviteteve dhe qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare të projekteve;
- g. vendosjen e 2 "kampeve bazë"/struktura të përkohshme – tenda ushtrie, që do të vendosen në dy zonat e projektit në Tiranë dhe Turi, si hapësira për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në procesin e krijimit të punimeve dhe fillimin e debatit publik mbi temat kulturore dhe historike, artistike, urbanistike lidhur me figurën e Antonio Gramsci, duke pasur parasysh në veçanti kujtesën dhe identitetin;
- h. xhirimin dhe transmetimin audio-vizual të aktiviteteve të kryera në "kampet bazë" përmes bashkëpunimit midis Qendrës Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë dhe Komisionit të Filmit të Pulias.

## **Neni 2** **Detyrimet e Rajonit të Pulias**

2. Me qëllim të zbatimit të projektit "Compagni e Angeli"- Drejt Oficinës së Kulturës", Rajoni i Pulias, nëpërmjet Departamentit të saj të industrisë së Turizmit dhe Kulturës - Departamenti i Turizmit, Ekonomisë së Kulturës dhe Valorizimit Territorial, merr përsipër:
  - a. të mbështesë, edhe finanziarisht, zhvillimin e projektit final të artit të përmendur në pikën 1 më lart;
  - b. të vendosë në dispozicion subjektet e saj pjesëmarrëse (Promovimi i Pulias, Teatri Publik Puliez, Komisioni i Filmit Apulia), bazuar në kompetencat e secilës, për të ndjekur në mënyrë efektive qëllimet e projektit artistik dhe zbatimin e plotë të tij;

- c. të verifikojë të gjitha profilet e koherencës së projektit artistik me projektet e bashkëpunimit ndër-rajonal që tashmë janë duke u zhvilluar si në Pulia ashtu edhe në Shqipëri.

### **Neni 3** **Detyrimet e MKSH**

3. Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë merr përsipër:

- a. të realizojë projektin artistik, duke vënë në dispozicion tokat pranë Ministrisë që do të jepen për Parkun dhe duke garantuar të gjitha kushtet operative për ekzekutimin në të njëjtën hapësirë të punës artistike të dhënë nga mjeshtri Pirri të quajtur "Shokë dhe Engjëj 2." dedikuar figurës së Antonio Gramsci-t;
- b. të vërë në dispozicion të Projektit studiot kinematografike të Ish-Kinostudios "Shqipëria e Re" ngjitur me Ministrinë e Kulturës për qëllimet e përshkruara;
- c. të vendosë në dispozicion institucionet e saj të kopetencës sipas aktivitetit përkatës, bazuar në kompetencat e secilës, për realizimin efektiv të qëllimeve të projektit artistik dhe zbatimin e plotë të tij.

### **Neni 4** **Detyrime të Përbashkëta**


4. Subjektet nënshkruese gjithashtu angazhohen që:

- a. të krijojnë, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, një Komitet Teknik të Përbashkët për të koordinuar dhe mbikëqyrur aktivitetet operative që synojnë realizimin e projektit dhe një Komitet Shkencor të Përzier që do të ketë detyrën e mbikëqyrjes së iniciativave nga këndvështrimi shkencor akademik, historik dhe filozofik , dhe të fillojë fazën e debatit publik në "kampet bazë të Oficinës së Kulturës";
- b. të përcaktojnë kushtet e dobishme për të prezantuar dhe mbështetur në partneritet projektin "Punëtoritë e Kulturës" dhe zhvillimet lidhur me të, në kuadër të instrumenteve strategjike dhe financiare të

programeve evropiane, veçanërisht në kuadër të projekteve tematike të Programit të Bashkëpunimit Shqipëri-Itali-Mali i Zi.

**Ministri i Kulturës**  
**Mirela Kumbaro Furxhi**

---



**Presidenti i Rajonit të Pulias**  
**Michele Emiliano**

